



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 gusht 2017
Nr. ref.:AGJ 1114/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI104/16

Parashtrues

Miodrag Pavić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML-KZZ. nr. 110/2016, të 16 majit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Miodrag Pavić nga fshati Koretishtë, komuna e Novobërdës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati Azem Vllasi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin [PML-KZZ. nr. 110/2016] e Gjykatës Supreme të 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015. Aktgjykimi i kontestuar [PML-KZZ. nr. 110/2016] i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 qershor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur [PML-KZZ. nr. 110/2016] të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masën e përkohshme, me të cilën do të pezullohet fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg derisa të merret një vendim nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, neni 27 [Masat e përkohshme], neni 47 [Kërkesa individuale] dhe neni 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29, 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 30 shtator 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
9. Më 21 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin fillestar të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

10. Bazuar në nenin 22.9 të Ligjit dhe në rregullin 35, 7 të Rregullores së punës, Gjyqtari raportues i dorëzoi Kolegjit shqyrtues një raport të rishikuar.
11. Më 29 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe konstatimin për shkelje.
12. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri votoi që kërkesa të deklarohet e pranueshme dhe të konstatohet shkelje.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 9 nëntor 2012, Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria), për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit, parashtroi aktakuzën në Gjykatën Themelore në Prizren-Departamentin për Krimet e Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
14. Më 29 janar 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [K. nr. 82-2013], me të cilin e liroi parashtruesin e kërkesës nga aktakuza. Në Aktgjykim thuhet: *“Meqenëse me asnjë provë nuk është vërtetuar që i akuzuari [parashtruesi i kërkesës] ka kryer vepër penale me të cilën akuzohet, respektivisht veprën penale, marrje mitos nga neni 343 al. 2 të KPK, i njëjti lirohet nga propozimi i aktakuzës”.*
15. Prokuroria paraqiti ankesën në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë çështjen në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit, ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës së Prokurorisë.
16. Më 15 korrik 2015, Gjykata e Apelit mbajti një seancë për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shkresat e lëndës, rezulton se në bazë të nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), parashtruesi i kërkesës nuk ishte njoftuar për seancën e Gjykatës së Apelit, pasi ai nuk ishte duke vuajtur dënimin me burgim.
17. Gjatë seancës së 15 korrikut 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015], me të cilin aprovoi ankesën e Prokurorisë dhe ndryshoi Aktgjykimin [K. nr. 82-2013] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej një viti. Në arsyetimin e Aktgjykimit, *inter alia*, thuhet:

“Duke pasur parasysh këtë gjendje faktike, Gjykata e Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka vërtetuar gjendjen faktike, por nuk ka zbatuar drejtë kodin penal. Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret, ka shkelur ligjin në

dobi të të akuzuarit në prani të këtyre fakteve, gabimisht ka vlerësuar që duhet të lirohet nga akuza”.

18. Kundër Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015], parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme duke pretenduar, *inter alia*, se Gjykata e Apelit mbajti seancë në të cilën ai u shpall fajtor, pa u njoftuar për seancën, dhe kështu nxori vendim në shkelje të KPPK-së.
19. Më 1 dhjetor 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, për mosinformin në lidhje me seancën në të cilën ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me një vit burgim, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi:

“Gjykata Supreme ka përfunduar që një obligim i tillë i gjykatës së shkallës së dytë - nuk ekziston. Në bazë të rregullave të sipërpërmendura (neni 390.1 të KPPK), kur të akuzuarit iu është shpallur dënimi me burg, njoftimi për mbajtjen e seancës së Kolegjit të Apelit i dërgohet prokurorisë kompetente, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij. Pra, nuk është e paraparë që gjykata e shkallës së dytë, në rastet kur palët kërkojnë, edhe pse të akuzuarit nuk iu është shpallur dënimi me burg, është e obliguar të informojë për mbajtjen e seancës”.

20. Parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] dhe Aktgjyimit të Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015]. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia*, se:

“Është shkelur dispozita e nenit 390 të KPK, duke marrë parasysh që i dënuari dhe mbrojtësi i tij nuk janë lajmëruar për seancën e trupit gjykues të gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë që të japin arsyetimet e tyre për pretendimet e prokurorit të paraqitura në përgjigjen në ankesë”.

21. Më 16 maj 2016, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PML-KZZ nr. 110/2016], me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Në lidhje me pretendimet e përsëritura të parashtruesit të kërkesës për mosinformim lidhur me seancën në të cilën ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me një vit burgim, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj arsyetoi duke theksuar *inter alia*, se:

“Gjykata Supreme ka përfunduar që një obligim i tillë i gjykatës së shkallës së dytë - nuk ekziston. Në bazë të rregullave të sipërpërmendura (neni 390.1 të KPPK), kur të akuzuarit iu është shpallur dënimi me burg, njoftimi për mbajtjen e seancës së Kolegjit të Apelit i dërgohet prokurorisë kompetente, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij. Pra, nuk është e paraparë që gjykata e shkallës së dytë, në rastet kur palët kërkojnë, edhe pse të akuzuarit nuk iu është shpallur dënimi me burg, është e obliguar të informojë për mbajtjen e seancës”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. KZZ. nr. 110/2016], duke pretenduar se me këtë Aktgjykim shkelen të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
23. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se mbrojtja me rastin e paraqitjes së përgjigjes në ankesën e Prokurorisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, kishte kërkuar që të njoftohet me kohë për seancën e Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të faktit se Gjykata e Apelit e ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në tërësi, dhe e shpalli parashtruesin fajtor duke e dënuar atë me një vit burg, ka qenë e obliguar ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për seancën e mbajtur. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
24. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/15] është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 390.1 të KPPK-së sepse parashtruesi i kërkesës, si palë e akuzuar, nuk ka qenë i njoftuar për seancën e Gjykatës së Apelit dhe në këtë mënyrë, i është privuar e drejta për të paraqitur argumentet e tij.
25. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [PAKR nr. 222/15] i Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me: a) nenin 403 të KPPK-së; b) nenin 382 të KPPK-së, pasi ai ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, duke shpallur të akuzuarin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës fajtor, pavarësisht nga fakti që Prokuroria propozoi në ankesën e saj anulimin e Aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes në rigjykim; dhe c) nenin 384 të KPPK-së, pasi përmban kontradikta mbi faktet vendimtare.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Në mënyrë që të përcaktojë nëse kërkesa e parashtruesit është e pranueshme, Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilat parashohin që:

*Neni 48
Saktësimi i kërkesës*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
Afatet*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.”

29. Lidhur me atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML- KZZ. nr. 110/2016], pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
30. Gjykata, në fund, konsideron se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Ajo konsideron më tej se nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, duhet të shpallet e pranueshme. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 9 korrikut 2012, *Ali Muçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, paragrafi 144).
31. Pasi që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës, Gjykata konsideron se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim të meritave.

Meritat

32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
33. Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është se Gjykata e Apelit pa e ftuar parashtruesin e kërkesës në seancë, dhe në mungesë të ndonjë përfaqësuesi ligjor të tij, ka mbajtur seancë më 15 korrik 2015, dhe e ka

shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale për të cilën ai është akuzuar.

34. Parashtruesi i kërkesës ankohet se, edhe pse u lirua nga të gjitha akuzat në shkallë të parë, Gjykata e Apelit e shpalli atë fajtor pa e lejuar atë që të merr pjesë në seancën e saj, qoftë personalisht ose përmes përfaqësuesit të tij ligjor. Ai pretendon se atij i ishte mohuar mundësia për të paraqitur mbrojtjen e tij, për të kontestuar provat, dhe për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, ose për të paraqitur dëshmitarë në emër të tij.
35. Parashtruesi i kërkesës i ka ngritur pretendimet e njëjta dy herë para Gjykatës Supreme, duke pretenduar se këto shkelje procedurale ishin kryer nga Gjykata e Apelit. Parashtruesi i kërkesës paraqiti këto argumente së pari para Gjykatës Supreme në lidhje me ankesën pas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të cilën Gjykata Supreme e ka refuzuar me Aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015], dhe më vonë, përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilën Gjykata Supreme me Aktgjykimin [PML-KZZ nr. 110/2016] gjithashtu e kishte refuzuar si të pabazuar.
36. Për të vlerësuar meritat e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari rikujton dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe KEDNJ-së:

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës:

“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.”

Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”

[...]

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

(d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; [...]"

37. Gjykata gjithashtu thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës: *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*
38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se praktika e qëndrueshme e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të meritave të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi.
39. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tij ngrenë çështje të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë nga neni 6.1 i KEDNJ-së, si dhe garancitë e veçanta të cilat neni 6 i përcakton në paragrafin 3 c) dhe d) të KEDNJ-së, e të cilat i referohen të drejtës për mbrojtje të të akuzuarit, si dhe të drejtave të tij për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës. Sipas praktikës të qëndrueshme të GJEDNJ-së, të gjitha provat në parim duhet të administrohen në praninë e të akuzuarit, të cilit duhet t'i jepet mundësia që gjatë gjyimit t'i kundërshtojë akuzat dhe provat mbi të cilat bazohet akuza.
40. Gjykata, rrjedhimisht, përkujton se e drejta në proces të rregullt në parim nënkupton të drejtën e palëve për të qenë personalisht të pranishëm në gjykim dhe se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën për seancë dëgjimore dhe me të drejtën e përcjelljes së procedurës personalisht. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 23 shkurtit 1994, *Fredin kundër Suedisë*, Aplikacioni nr. 18928/91, faqe 10 dhe 11; dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, i 26 majit 1988, *Ekbatani kundër Suedisë*, Kërkesa nr. 10563/83, paragrafi 25).
41. Në paragrafët e mëposhtëm, Gjykata do t'i referohet parimeve kyçe të vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së lidhur me të drejtën për një

seancë dëgjimore dhe mënyra në të cilën ato zbatohen mbi pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe meritave të rastit konkret.

Lidhur me të drejtën për seancë dëgjimore

42. Gjykata rikujton se edhe pse nuk përmendet shprehimisht në tekstin e nenit 6 të KEDNJ-së, një seancë dëgjimore përbën një ndër parimet themelore të përcaktuara në nenin 6 (1). (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 23 nëntorit 2006, *Jussila kundër Finlandës*, nr. 75053/01).
43. Megjithatë, GJEDNJ-ja gjithashtu pohon se “në rastet në të cilat ka pasur një seancë dëgjimore në shkallë të parë, ose për të cilën është hequr dorë në atë nivel, nuk ka të drejtë absolute për një seancë dëgjimore në çdo procedurë ankimore që jepet”, (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 nëntorit 2002, *Döry kundër Suedisë*, nr. 28394/95, paragrafi 37).
44. Kur procedura përfshin një ankesë vetëm për çështje të ligjit, përgjithësisht një seancë dëgjimore nuk është e detyrueshme. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 8 dhjetorit 1983, *Axen kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8273/78, paragrafi 28).
45. Nëse një gjykatë apeli i kërkohet të vendosë për çështje të faktit, një seancë dëgjimore mund të kërkohet ose jo, në varësi të asaj se a është e nevojshme që të sigurohet një gjykim i drejtë.
46. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nëse është e nevojshme një seancë dëgjimore në nivelin e apelit, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së “varet nga karakteristikat e veçanta të procedimeve përkatëse, duhet të merren parasysh tërësia e procedimeve në rendin e brendshëm juridik dhe e rolit të gjykatës së apelit në të”. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 26 majit 1988, *Ekbatani kundër Suedisë*, Kërkesa nr. 10563/83, paragrafi 27, dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, i 2 marsit 1987, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 9562/81; 9818/82, faqe 56).
47. Për më tepër, kur një gjykatë apeli duhet të shqyrtojë një çështje sa i përket fakteve dhe ligjit dhe të bëjë një vlerësim të plotë të çështjes së fajit apo të pafajësisë, nuk mund ta përcaktojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i akuzuari, për të dëshmuar se ai ka kryer ose jo veprën e cila pretendohet se përbën një vepër penale. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 9 qershorit 2009, *Sobolewski (nr.2) kundër Polonisë* kërkesa nr. 19847/07, paragrafi 35, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së së 6 korrikut 2004, *Dondarini kundër San Marino*, kërkesa nr. 50545/99, paragrafi 27).
48. Gjykata gjithashtu vëren se sipas GJEDNJ-së, një seancë dëgjimore ishte kërkuar lidhur me ankesën, ku ka pasur një kontest sa i përket fakteve në një çështje penale që afektonte kredibilitetin e të akuzuarit: fajësia ose pafajësia e të akuzuarit “nuk mund, si çështje e gjykimit të drejtë, të jetë përcaktuar siç duhet pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga parashtruesi”. (shih aktgjykimin e lartcekur *Ekbatani kundër Suedisë*, paragrafi 32).

49. Rrjedhimisht, Gjykata përmbledh se e drejta për një seancë dëgjimore në procedurën ankimore nuk është absolute sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Në përgjithësi, ajo nuk kërkohet kur procedurat ankimore përfshijnë shqyrtim vetëm të çështjeve të ligjit. Nëse është seanca e nevojshme kur procedurat përfshijnë të dy çështjet, ato të ligjit dhe të fakteve, varet nëse një është e nevojshme për të siguruar gjykim i drejtë. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kur procedurat ankimore përfshijnë një vlerësim të fajësisë apo të pafajësisë, seanca dëgjimore është e detyrueshme për të siguruar gjykimin e drejtë. Gjykata rikujton se në rastin konkret, Gjykata e Apelit bëri vlerësimin e fajësisë ose të pafajësisë së parashtruesit të kërkesës, dhe e shpalli atë fajtor, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur i pafajshëm.

Aplikimi i praktikës relevante të GJEDNJ-së në rastin e tanishëm

50. Gjykata fillimisht vëren se në procedurën në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës u dëgjua gojarisht lidhur me veprën penale për të cilën ai ishte akuzuar. Më pas, Gjykata Themelore zhvilloi procedurën e provave përgjatë të cilës dëgjoi dëshmitarët dhe u paraqitën dëshmi të tjera. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përfitoi nga asistencë ligjore dhe iu mundësua të paraqesë mbrojtjen e tij në mënyrë të tillë që, me dëshmitë dhe argumentet e tij, ai ishte në gjendje të kundërshtonte dhe të kontestonte provat dhe akuzat penale. Për këto arsye, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte përfituar nga e drejta për një seancë dëgjimore në procedurat para gjykatës së shkallës së parë. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga të gjitha akuzat nga gjykata e shkallës së parë.
51. Pastaj në procedurën në Gjykatën e Apelit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim njëvjeçar, pa iu dhënë mundësia për të marrë pjesë në seancë.
52. Prandaj, Gjykata tani duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës do të duhej të kishte përfituar gjithashtu nga garancitë e plota të një seance dëgjimore në procedurën e ankesës në Gjykatën e Apelit.
53. Gjykata së pari vëren se edhe në procedurën ankimore dhe atë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës përmendi faktin se Gjykata e Apelit i kishte mohuar atij të drejtën në një gjykim të drejtë duke e përjashtuar atë nga procedura në të cilën ai ishte dënuar për një vepër penale.
54. Gjykata Supreme dy herë refuzoi pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në përmbajtjen e nenit 390.1 të KPPK-së, i cili përcakton që:

Neni 390
Seanca para Kolegjit të Apelit

“1. Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të apelit i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij”.

55. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me interpretimin e kësaj dispozite arsyetoi se: *“meqenëse i pandehuri është shpallur i pafajshëm, Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nuk ka pasur obligim ta njoftojë atë për mbajtjen e seancës”.*
56. Megjithatë, Gjykata rikujton që Gjykata e Apelit, në seancën e mbajtur më 15 korrik 2015, vendosi të mos anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore e të kthejë rastin e Gjykatës Themelore për rigjykim, por në vend të kësaj, t’a ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Duke vepruar kështu, Gjykata e Apelit pati mundësi të mbajë shqyrtim, në bazë të neneve 391 dhe 392.1 të KPPK-së, në të cilin skenar, sipas nenit 392.2 të KPPK-së, ajo do të duhej të ketë ftuar në shqyrtim të gjitha palët relevante, si të akuzuarin po ashtu edhe përfaqësuesin e tij. Përderisa interpretimi i KPPK-së është një prerogativë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë, pretendimet e parashtruesit të kërkesës në çështjen konkrete për sa i përket së drejtës së tij për një seancë dëgjimore, si pjesë përbërëse e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së i përkasin çështjeve të kushtetutshmërisë.
57. Për të përcaktuar nëse kërkesat kushtetuese të drejtësisë lidhur me të drejtën për seancë dëgjimore janë përmbushur në rastin në fjalë, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë natyrën e procedurës para Gjykatës së Apelit dhe rëndësinë e saj në kontekstin e procedurës penale si tërësi; fushëveprimin e kompetencave të Gjykatës së Apelit; dhe mënyrën në të cilën interesat e parashtruesit të kërkesës ishin paraqitur dhe mbrojtur në Gjykatën e Apelit. (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 2 marsit 1987, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 9562/81, 9818/82, p.56).
58. Rrjedhimisht, duhet t’i kushtohet vëmendje çështjeve të mëposhtme: (1) a ishte e thirrur Gjykata e Apelit që të shqyrtojë çështjen në lidhje me faktet dhe ligjin; (2) a ishte e thirrur Gjykata e Apelit që të bënte një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i akuzuari; dhe (3) a ishte e thirrur Gjykata e Apelit që të bënte një vlerësim të plotë për çështjen e fajit apo të pafajësisë.
59. Gjykata rithekson se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cituar më lart, kur një procedurë ankimore për përcaktimin e një akuze penale kërkohet që të shqyrtojë një çështje në lidhje me faktet dhe ligjin dhe të bëjë një vlerësim të plotë të çështjes së fajit apo të pafajësisë, nuk mund ta përcaktojë çështjen pa një vlerësim të plotë e të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i akuzuari, me qëllim të dëshmisë se ai e ka kryer ose jo veprën që pretendohet se përbën vepër penale. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 9 qershorit 2009,

Sobolewski (nr. 2) kundër Polonisë, Kërkesa nr. 19847/07, paragrafi 35 dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 6 korrikut 2004, *Dondarini kundër San Marinos*, Aplikimi nr. 50545/99, paragrafi 27).

60. Gjykata vëren se në rastin konkret, për shkak se parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga të gjitha akuzat në shkallë të parë, Gjykata e Apelit ishte e thirrur për të shqyrtuar të gjitha aspektet e fakteve dhe ligjit dhe për të bërë një vlerësim të plotë të çështjes së fajit apo pafajësisë.
61. Gjykata e Apelit, si dhe arsyetimi i të dy Aktgjykimeve pasuese të Gjykatës Supreme, [PML-KZZ. nr. 110/2016] i 16 majit 2016 dhe [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015, respektivisht, konsideroi se gjendja faktike ishte vërtetuar drejtë nga Gjykata Themelore dhe, prandaj, Gjykata e Apelit nuk e shqyrtoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore lidhur me çështjet e fakteve, por vetëm me çështjet e ligjit. Megjithatë, Gjykata konsideron se në rastin në fjalë për të bërë vlerësimin e saj lidhur me zbatimin e ligjit në faktet e vërtetuara të rastit, Gjykata e Apelit ishte e detyruar që të vendosë vetë lidhur me rastin dhe rrjedhimisht, ishte e thirrur të bëjë një vlerësim të plotë të fajësisë ose pafajësisë së parashtruesit të kërkesës.
62. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se, në rrethanat e rastit konkret, dallimi midis “rishqyrtimit të fakteve” dhe “shqyrtimit të zbatimit të ligjit në faktet e vërtetuara” është një dallim artificial. Në të dyja rastet, Gjykata e Apelit ishte e detyruar të vlerësojë vlefshmërinë e provave.
63. Gjykata gjithashtu përkujton që, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafin 1 dhe 3 (c), vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat procedurës penale. E drejta në mbrojtje sipas nenit 6, paragrafi 3, pika (c), përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit për të qenë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë.
64. Prandaj, Gjykata konsideron se, për të ardhur deri te një konstatim i fajit, Gjykata e Apelit do të duhej të bënte një vlerësim të tillë të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga parashtruesi i kërkesës me qëllim që të dëshmojë se ai ka kryer veprën që pretendohet se përbën vepër penale.
65. Gjykata vëren se, në këto rrethana, nuk ishte e mundur që Gjykata e Apelit të bënte një vlerësim të tillë të plotë, pa bërë vlerësimin e provave të dhëna personalisht nga parashtruesi i kërkesës.
66. Më tej, në rastin konkret, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit ka shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për akuza për të cilat ai ishte liruar fillimisht, pa e thirrur parashtruesin e kërkesës në seancë dhe pa e njoftuar as parashtruesin ose përfaqësuesin e tij ligjor se do të mbahej seanca gjyqësore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk e dinte fare se ishte mbajtur një seancë dëgjimore në Gjykatën e Apelit lidhur me ankesën e Prokurorisë, në të cilën ai ishte shpallur fajtor dhe ishte burgosur deri në një vit.

67. Si pasojë e mosnjoftimit, Gjykata konsideron se, në procedurat para Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës ishte privuar nga të gjitha të drejtat dhe garancitë. Atij nuk iu dha mundësia të mbrohej personalisht, nuk kishte pasur mundësi të paraqiste mbrojtjen e tij dhe të kundërshtonte argumentet e palës tjetër, nuk kishte asistencë ligjore, dhe as nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në procedurat në fazën ku Gjykata e Apelit e shpalli atë fajtor. Përveç kësaj, kjo situatë nuk mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës, por bie në përgjegjësinë e gjykatës kompetente, e cila nuk e kishte njoftuar atë për seancën e mbajtur.
68. Rrjedhimisht dhe në bazë të gjithë asaj që u tha më lart, duke pasur parasysh tërësinë e procedurave para gjykatave të rregullta, rolin e Gjykatës së Apelit dhe natyrën e çështjes së adresuar dhe vendosur nga ajo, Gjykata konkludon se në rastin konkret ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), paragrafët 1 dhe 3, pika (c) dhe (d) të KEDNJ-së, sepse parashtruesit të kërkesës i është pamundësuar të merr pjesë në seancën e mbajtur lidhur me akuzën penale kundër tij.
69. Gjykata thekson se ky përfundim i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë nuk paragjykon në asnjë mënyrë rezultatin e përsëritjes së procedurave penale në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e parashtruesit të kërkesës.
70. Duke gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 dhe 3, nën (c) dhe (d) të KEDNJ-së, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme t'i adresojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
71. Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se ato ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetime të detajuara rreth tyre, në të dyja Aktgjykimet e saj, [PA-II. nr. 6/2015] dhe [PML-KZZ nr. 110/2016], respektivisht.

Kërkesa për masë të përkohshme

72. Duke pasur parasysh se Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML-KZZ. nr. 110/2016] i 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015, ka shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit për miratimin e masës së përkohshme.

Përfundim

73. Në përfundim, Gjykata konstaton se duke mos e ftuar parashtruesin e kërkesës të jetë i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit në të cilën është përcaktuar fajësia e tij, parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar mundësia për t'u mbrojtur

ndaj akuzave kundër tij. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafët 1 dhe 3, nën (c) dhe (d) të KEDNJ-së.

74. Pasi ka gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 dhe 3, nën (c) dhe (d) të KEDNJ-së, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme adresimin e pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës.
75. Përveç kësaj, duke gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 dhe 3, nën (c) dhe (d) të KEDNJ-së, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit për miratimin e masave të përkohshme.
76. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML-KZZ. nr. 110/2016] i 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015, shpallet i pavlefshëm dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, rasti i kthehet Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim të ri.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 56.1 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 maj 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML-KZZ. nr. 110/2016] i 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015, ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës;
- IV. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML-KZZ. nr. 110/2016] të 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015, sepse ky Aktgjykim nuk janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;
- V. TA KTHEJË rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- VI. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VII. TË MBETET e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IX. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit.
- X. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi